

# PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN  
FINANCIAR TË KOSOVËS

## REGJISTRI I PENGUT PËR SENDET E LUAJTSHME

# PERIODIKU BANKAR



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 Banka Ekonomike



 BPB

 iSBANK

 NLB Banka

 ProCredit Bank

 Raiffeisen  
BANK

 TEB  
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

 ZiraatBank

PËRGATITUR NGA:

DR. SC. PETRIT BALIJA,  
Kryeredaktor

KRESHNIK KOSUMI,  
Redaktor

MIRANDA RUGOVAJ  
Koordinatore

MITHAT SEJDIU  
Dizajn

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,  
Dhjetor 2016



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Deklarata e autorësisë: Materiali në këtë publikim ka të drejta autoriale. Kopjimi apo përdorimi i një pjese apo i tërë publikimit pa leje apo pa shënuar burimin e informacionit mund të konsiderohet shkelje e ligjeve në fuqi.

# REGJISTRI I PENGUT PËR SENDET E LUAJTSHME

## PËRMBAJTJA

### PJESA I

Regjistri i pengut në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë 1

Baza ligjore 1

Funksioni dhe qëllimi 1

### PJESA II

Indikatorët kryesorë të industrisë bankare të paraqitura në numra dhe figura 2

Struktura e asetëve 2-3

Struktura e detyrimeve 3-4

Të hyrat dhe shpenzimet 5-7

Norma efektive e interesit në kredi 8-8

Norma efektive e interesit në depozita 8-9

Kreditë jo-performuese 9-11

### PJESA III

Lajme nga industria bankare dhe ekonomia 12-20

# I. REGJISTRI I PENGUT NË KUADËR TË MINISTRISË SË TREGTISË DHE INDUSTRIË

## BAZA LIGJORE

Regjistri i pengut në Kosovë vepron në bazë të Ligjit nr.04/L-136 për Regjistrimin e Pengut për Sendet e Luajshme. Ky regjistër funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht në kuadër të Agjencionit të Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë.

Përmes këtij ligji përcaktohen procedurat dhe kushtet e regjistrimit të pengut në regjistër për sendet e luajshme, ndryshimi, kërkimi i informacionit si dhe administrimi i regjistrimit të pengut. Ky ligj zbatohet për të gjitha transaksionet ose të drejtat që sipas ligjeve të Kosovës mund të regjistrohen në regjistrin e pengut.

Organizimi dhe funksionimi i Sektorit të regjistrimit të pengut rregullohet me akt nënligjor për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Regjistri i pengut bën regjistrimin e pengut përmes Udhëzimit Administrativ Nr.16/2016

## FUNKSIONI DHE QËLLIMI

Sektori i regjistrimit të pengut është përgjegjëse për pranimin dhe arkivimin e të dhënave përkitazi me pengun e sendeve të luajshme dhe ofrimin e mundësive publikut për kërkim të pengut si dhe pëmbajtjen e përditësuar të të gjitha shënimeve përkatëse. Sektori për regjistrimin e pengut regjistron dhe menaxhon informacionin lidhur me pengun dhe është përgjegjës për kryerjen e funksioneve tjera të përcaktuara me ligj.

Ndër detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të sektorit të pengut kanë të bëjnë me:

- regjistrimin e pengut përmes SRP-së (Sistemi i regjistrimit të pengut);
- kërkimin e informacioneve përmes SRP-së;
- lëshimin e CRP-ve (Certifikata e regjistrimit të pengut), dhe
- kryerjen e të gjitha funksioneve tjera që i janë dhënë zyrës në bazë të ligjit në fuqi.

Komunikimi në kuadër të Regjistrimit të Pengut bëhet në kohë reale në formë elektronike dhe pa kufizime për regjistrimin e pengut. Në këtë regjistër mund të kenë qasje të gjithë personat individual fizik dhe ata juridik. Qasje për regjistrim elektronik të pengut e kanë të gjitha Institucionet Bankare, Mikrofinanciare, Avokatet, Noterët, Kompanitë e Lizingut dhe Institucionet shtetërore. Funksionimi i Regjistrimit të Pengut ka për qëllim që të lehtësoj dhe inkurajoj financimin e sigurtë

për Përcaktimin e Procedurave për Regjistrimin e Pengut, Taksave dhe Shërbimet tjera. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.04/L-136 në fund të vitit 2012 dhe deri në nëntor 2016, regjistrimi i pengut është bërë në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2013 për përcaktimin e Taksave për Regjistrimet dhe



shërbimet tjera të kryera nga sektori i pengut.

Para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-136, Zyra e Pengut ka funksionuar në bazë të rregullores 2001/32 për Themelimin e Zyrës së Regjistrimit të Pengut.

për pasuritë e luajshme, duke kontribuar kështu në një mbrojtje efektive të procesit të kredidhënies. Regjistri i pengut ka për qëllim gjithashtu maksimalizimin e efikasitetit, minimizimin e shpenzimeve operacionale dhe zvogëlimin e riskut, në mënyrë që të krijohen kushte më të mira dhe siguri për kreditë e lëshuara. Ky regjistër gjithashtu mundëson krijimin e një ambienti më tërheqës për bizneset dhe krijimin e një bilanci në tregun e kredive në vendin tonë.

## II. INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRIËS BANKARE

### Struktura e asetëve

STRUKTURA E ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010-2016) (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Te-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.0	426.9
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.8	316.0	295.0
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.3	490.6
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.3	2,019.5	2,197.4
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.0	56.7
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	28.8	28.5	37.9
<b>Gjithsej Asete</b>	<b>2,455.1</b>	<b>2,649.7</b>	<b>2,829.3</b>	<b>3,059.3</b>	<b>3,186.6</b>	<b>3,385.3</b>	<b>3,504.7</b>

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

PËRBËRJA E STRUKTURES SË ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010 -2016) (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Te-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.5%	12.5%	15.0%	15.1%	14.0%	14.5%	12.2%
Bilanci me bankat komerciale	17.9%	12.4%	10.2%	11.1%	12.3%	9.3%	8.4%
Letrat me vlerë	7.1%	7.6%	9.1%	11.6%	12.0%	14.0%	14.0%
Kreditë dhe lizingu	59.4%	64.1%	62.3%	59.0%	59.1%	59.7%	62.7%
Asetet fikse	1.8%	1.8%	2.0%	1.8%	1.7%	1.7%	1.6%
Asetet tjera	1.3%	1.6%	1.3%	1.3%	0.9%	0.8%	1.1%
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Tab. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010 - 2016)											
(milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4
Te-2016	59.4	27.3	165.6	19.1	102.1	700.2	45.2	21.0	99.4	148.1	1,387.6

Tab. 3 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

PJESËMARRJA E KREDIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010-2016)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	3.7%	1.4%	12.5%	1.8%	10.7%	51.0%	3.9%	1.9%	2.2%	11.1%	100.0%
2011	3.5%	1.5%	11.9%	1.3%	10.1%	52.7%	3.5%	2.0%	4.8%	8.7%	100.0%
2012	3.7%	1.4%	11.1%	1.3%	10.5%	53.2%	3.2%	1.9%	4.6%	9.1%	100.0%
2013	3.8%	1.7%	10.8%	1.7%	9.8%	52.6%	4.0%	1.6%	5.6%	8.4%	100.0%
2014	4.0%	1.6%	12.2%	1.6%	8.5%	53.7%	4.1%	1.4%	4.8%	8.1%	100.0%
2015	4.5%	1.4%	12.3%	1.3%	7.5%	51.2%	3.8%	1.6%	7.1%	9.3%	100.0%
Te-2016	4.3%	2.0%	11.9%	1.4%	7.4%	50.5%	3.3%	1.5%	7.2%	10.7%	100.0%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

## Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIJË BANKARE (2010-2016)							
(milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Te-16
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	32.2	43.4	72.7
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,702.9	2,774.6
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6	18.7
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	2.7	3.4
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.9	189.1	187.4
Borxhi i ndërruar	33.5	31.0	31.0	56.3	47.2	36.9	38.1
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.1	392.7	409.9
<b>Gjithsej Detyrime</b>	<b>2,455.1</b>	<b>2,649.7</b>	<b>2,829.3</b>	<b>3,059.3</b>	<b>3,186.6</b>	<b>3,385.3</b>	<b>3,504.7</b>

Tab. 5 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

## PJESËMARRJA E STRUKTURËS SË DETYRIMEVE TË INDUSTRIË BANKARE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Te-16
Bilanci nga bankat tjera	2.9%	1.5%	0.2%	0.5%	1.0%	1.3%	2.1%
Depozitat	78.9%	79.4%	80.6%	80.1%	79.6%	79.8%	79.2%
Huatë tjera	1.0%	1.1%	0.7%	0.4%	0.4%	0.5%	0.5%
Provizionet e shlyera	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
Detyrimet tjera	6.5%	7.2%	7.8%	8.0%	7.2%	5.6%	5.3%
Borxhi i ndërruar	1.4%	1.2%	1.1%	1.8%	1.5%	1.1%	1.1%
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.0%	0.0%	-	-	-
Mjetet vetanake	9.4%	9.5%	9.6%	9.1%	10.1%	11.6%	11.7%
<b>Gjithsej Detyrime</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Tab. 6 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese




Fig.2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

## Të hyrat dhe shpenzimet

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (2010-2016) (milion euro)									
Periodha	Të hyrat nga interesi					Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Gjithsej të hyra nga interesi	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	175.4	169.6	2.7	3.1	-	37.5	3.9	0.3	217.1
2011	194.6	186.3	4.1	4.2	-	41.7	3.3	0.0	239.6
2012	199.2	194.9	2.0	2.3	-	44.9	2.4	0.7	247.1
2013	198.2	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	193.5	189.5	1.1	2.9	-	44.5	3.3	2.9	244.2
2015	186.0	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 7 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 3 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese



**SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (2010-2015)**  
 (milion euro)

Periudha	Shpenzimet e interesit				Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Gjithsej shpenz.e interesit	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
2010	55.2	49.4	4.8	1.0	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.0	184.3
2011	58.4	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	63.1	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	63.8	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	44.0	36.4	3.1	4.5	11.1	20.5	42.4	34.8	24.5	6.8	184.2
2015	22.6	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 8 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 4 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)									
Periudha	Të hyrat nga interesi					Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Gjithsej të hyra nga interesi	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhurat tjera operative		
Te-2015	156.2	151.3	0.5	3.7	0.7	38.7	3.0	1.0	<b>198.8</b>
Te-2016	149.1	-	-	-	-	39.7	2.8	1.9	<b>193.5</b>

Tab. 9 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)											
Periudha	Shpenzimet e interesit				Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Gjithsej spenz. e interesit	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
Te-2015	19.4	14.3	3.2	1.8	9.9	0.2	36.6	28.1	21.3	7.9	<b>123.3</b>
Te-2016	15.2	-	-	-	13.6	14.6	35.1	35.9	10.0	4.2	<b>128.5</b>

Tab. 10 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

## Normat efektive të interesit në kredi

### NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Te-16
Norma efektive në kredi të reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.29%
Norma efektive për korp.jofinanc.	14.11%	13.04%	12.34%	10.75%	9.56%	7.39%	6.94%
Norma efektive për ek.familjare	13.77%	13.85%	12.00%	11.33%	8.88%	8.39%	7.71%

Tab. 11 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar




Fig. 7 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

## Normat efektive të interesit në depozita

### DIFERENCA NDËRMJET NORMAVE TË INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Te-16
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.29%
Norma efektive për gjithsej depozitat e reja	3.38%	3.62%	3.72%	2.40%	1.11%	1.15%	0.89%
<b>Diferenca</b>	<b>10.59%</b>	<b>9.68%</b>	<b>8.52%</b>	<b>8.50%</b>	<b>8.18%</b>	<b>6.54%</b>	<b>6.40%</b>

Tab. 12 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar




Fig. 8 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

## Kreditë jo-performuese

### KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Te-16
Vlera e kredive jo-performuese	86.1	96.8	132.3	157.1	154.4	125.2	109.9
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%	126.6%

Tab. 13 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

### KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Te-16
Kreditë jo-performuese (%)	5.9%	5.8%	7.5%	8.7%	8.3%	6.2%	5.0%
NPL rritja/zvogëlimi (%)	51.7%	12.5%	36.6%	18.8%	-1.7%	-18.9%	-12.2%
Përqindja e rritjes kreditore	13.2%	16.4%	3.8%	2.4%	4.2%	7.3%	8.8%

Tab. 14 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore




Fig. 9 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

## Referencat

Agjencia e Regjistrimit të bizneseve të Kosovës, Sektori i Pengut, nëntor 2016, <http://www.arbk.org/sq/Sektori-i-Pengut>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, nëntor 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, tetor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, nëntor 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, nëntor 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, nëntor 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.04/L-136 për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme, nëntor 2012, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2856>;

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr.16/2016 për Përcaktimin e Procedurave për Regjistrimin e Pengut, Taksave dhe Shërbimet tjera, nëntor 2016, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13028>;

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr.09/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Regjistrimin e Pengut, Taksave dhe Shërbimet tjera, qershor 2013, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13028>;

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Rregullorja nr.2001/32 për Themelimin e Zyrës së Regjistrimit të Pengut, nëntor 2001, [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001\\_32.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001_32.pdf);

## **PJESA III**

# **LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE DHE EKONOMIA QË SHËNUAN MUAJIN NËNTOR**

## BANKA EKONOMIKE NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN E GARANCISË ME FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE



Banka Ekonomike dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore nënshkruan marrëveshjen për garancinë kreditore e cila do të ju mundësoj ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme qasje më të lehtë në financime, gjithashtu edhe siguri më të madhe për bankën në aspekt të kredidhënies. Nga kjo marrëveshje do të përfitojnë më së shumti bizneset e grave, fermerët, gjithashtu edhe sipërmarrësit të cilët nuk kanë mundësi të ofrojnë kolateral të mjaftueshëm për sigurimin e kredisë. Njëkohësisht kjo marrëveshje ka për qëllim stimulimin e kredidhënies te ato biznese ku planet e tyre investive do të kontribuojnë në rritje ekonomike, si dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës. Procedura e aplikimit është e njëjtë me procedurat standarde të bankës dhe me këtë rast, nëse klienti nuk i përmbush plotësisht kushtet për marrje të kredisë si: minimum i kolateralit, minimum i hipotekës apo minimum i ndonjë lloji tjetër kolaterali, banka do t’ia mundësoj lëshimin e kredisë duke shfrytëzuar garancinë e FKGK-së. (Zëri, 3 nëntor 2016).



## “PROGRAMI PËR NDËRMARRËSI TË FEMRAVE” I TEB-IT MERR ÇMIM NDËRKOMBËTAR



TEB Banka e ka fituar çmim ndërkombëtar nga Global Banking Alliance for Women (GBA) , për ndërtimin dhe zhvillimin e ndërmarrësisë së femrave në mbarë botën. Anëtarët e kësaj Aleance punojnë në rreth 135 vende për të ndërtuar programe gjithëpërfshirëse inovative, për të ju ofruar femrave qasje në kapital, edukim dhe trajnime.

Samiti i organizuar nga Global Banking Alliance for Women (GBA) u mbajt nga 18 deri 20 tetor në Washington, të SHBA-ve.

Shumë banka nga të gjitha kontinentet prezantuan programet dhe strategjitë në zhvillimin e tregut për femrat në biznes.

Banka TEB mori pjesë në këtë samit me “Programin për Ndërmarrësi të Femrave” duke elaboruar komponentët e programit si financimi i bizneseve Start-Up, ofrimi i shërbimeve jo-financiare dhe rëndësia e ekosistemit në zhvillimin e tregut. Për realizimin dhe rezultatet e këtij Programi, Banka TEB është shpërblyer me çmimin GBA “Programi më i mirë i Ri” (Best program newcomer – GBA).

Banka TEB është e nderuar me vlerësimin ndërkombëtar për programin e saj të ndërmarrësisë për femra dhe ka për qëllim të intensifikojë aktivitetet e veta në avancimin e mëtejshëm të këtyre programeve.

Ndryshe, Global Banking Alliance for Women (GBA) – është një konsorcium lider ndërkombëtar i institucioneve financiare dhe organizatave të tjera të interesuara për ndërtimin dhe zhvillimin e ndërmarrësisë së femrave në mbarë botën. (Telegrafi, 3 nëntor 2016).

## PËRURUHET QENDRA E BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS NË PRIZREN



Sot në Prizren mbahet ceremonia e përrimit të Qendrës së Vazhdimësisë së Punës në Prizren të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), projekt ky i bashkëfinancuar nga Banka Botërore dhe i përkrahur nga Ministria e Financave. Qendra e Vazhdimësisë së Punës do i mundësoj BQK-së t'i sigurojë mbarëvajtjen e funksioneve të sajë në rastet e ngjarjeve të paparashikuara, e që mund të shkaktojnë ndërprerjen e aktiviteteve të rregullta të BQK-së dhe sektorit financiar. Në ceremoninë e përrimit marrin pjesë: Ministri i Financave Avdullah Hoti, guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës Bedri Hamza, drejtoresha Rajonale e Bankës Botërore për Evropën Juglindore, Evropën, Azinë Qendrore, si Ballkanin Perëndimor Ellen Goldstein, kryetari i Komunës së Prizrenit Ramadan Muja, si dhe zyrtarë të tjerë. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 7 nëntor 2016).

## FONDI KREDITOR, SHTYLLË PËR BIZNESET E KOSOVËS



Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, po kontribuon që të rritet qasja në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, e sidomos bizneset në pronësi të grave dhe sektorët tjerë ekonomikë që kanë qasje të limituar në financa. Edward Nolan, drejtori menaxhues në detyrë i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, institucion i themeluar me mbështetje të USAID-it në Kosovë, ka deklaruar se pranimi i garancive të kredive ka filluar që nga fundi i shtatorit të këtij viti, dhe portfolio deri më tani arrin shumën afër 3 milionë euro. Nolan, në një intervistë për RTKLive, ka thënë se synimi i fondit është të rritet qasja në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, e sidomos bizneset në pronësi të grave dhe sektorët tjerë ekonomikë që kanë qasje të limituar në financa. (Telegrafi, 11 nëntor 2016).

## FONDI PËR KREDI - MARRËVESHJE ME TË GJITHA BANKAT



Fondi Kosovar për Garanci Kreditore që nga funksionalizmi i tij në fillim të këtij viti, ka nënshkruar marrëveshje për garanci kreditore gati me të gjitha bankat komerciale në Kosovë, bëjnë të ditur zyrtarë të Qeverisë së Kosovës.

Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive është një institucion vendor i pavarur dhe i qëndrueshëm, i cili është menduar që t'u lëshojë garanci të pjesshme të kredive institucioneve financiare, duke rritur në këtë mënyrë qasjen në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë.

Sokol Havolli, shef i kabinetit në zyrën e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ka treguar se marrëveshjet e nënshkruara me bankat komerciale kanë për qëllim stimulimin e kredihënies për biznese, të cilat do të kontribuojnë në rritje ekonomike. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërzhaliu, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se sektori privat ballafaqohet me kamata të larta bankare, por edhe procedura burokratike. Sipas tij, Fondi për Garantimin e Kredive do t'i ndihmojë bizneset në zhvillimin e tyre, por që nuk do të jetë një shkop magjik që t'i zgjidhë problemet ekonomike të vendit. (Evropa e Lirë, Zëri, Epoa e Re, 14 nëntor 2016).

## TEB SH.A. NË PËRKRAHJE TË FEMRAVE NDËRMARRËSE



Sot, më 15 nëntor 2016, u mbajt event i "Gratë Ndërmarrëse në Kosovë" i organizuar nga Shoqata Afariste e Gruas (SHE-ERA) në bashkëpunim me Qendrën Inovative të Kosovës (ICK) dhe Forumin Ekonomik të Grave (FEG). Ky event u mbështet nga banka TEB Sh. A., PPSE/SwissContact dhe Instituti Riinvest.

Në këtë event moren pjesë Ministrija e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, Ambasadori i Norvegjisë Per Strand Sjaastad, Sigrid Meyer – Sëisscontact/PFSP dhe Orcun Ozdemir zëvendës

Drejtor Gjeneral i bankes TEB Sh.A.

Paneli diskutoi për programet e suksesshme në mbështetjen e grave ndërmarrëse - skemat e granteve, kredit dhe programe për të mbështetur gratë në biznes.

Po ashtu, u prezantuan stori e suksesit nga gratë ndërmarrëse të suksesshme të cilat diskutuan për vështërsitë dhe problemet që kanë hasur dhe mënyrat e tejkalimit të sfidave.

Ky aktivitet ishte pjesë e organizimit të "Javës globale të ndërmarrësisë" në Kosovë. (TEB, 16 nëntor 2016).

## ATK-JA DHE “RAIFFESEN BANK” ME MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI



Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri dhe drejtori ekzekutiv i “Raiffeisen Bank Kosova J.S.C (RBKO)”, Robert Wrighti së bashku me drejtorin e Departamentit Ligjor, Ilir Tahirin, kanë nënshkruar të enjten marrëveshje bashkëpunimi për lehtësimin e komunikimit, rritjen e efikasitetit dhe ofrimin e informatave të palëve të treta për ATK-në nga RBKO-ja.

Qëllimi i kësaj marrëveshje është që nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstucional të lehtësohet komunikimi, të rritet efikasiteti në ofrimin e

informatave për palët e treta nga ana e RBKO-së për ATK-në, në përputhje me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Kjo marrëveshje aplikohet vetëm për komunikimet elektronike në mes ATK-së dhe RBKO-së, gjegjësisht për parashtrimin e kërkesave të ATK-së dhe ofrimin e informatave për palët e treta nëpërmjet postës elektronike nga ana e RBKO-së për ATK-në. Marrëveshja në fjalë nuk aplikohet për komunikimet tjera që parashihen me ligjet e aplikueshme në Kosovë. (Epoka e Re, 18 nëntor 2016).

## TEB SH.A. NËNSHKROI MARRËVESHJEN E GARANCISË ME FONDI KOSOVAR PER GARANCI KREDITORE



Banka TEB SH.A. dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore kanë nënshkruar marrëveshjen për garancinë kreditore. Kjo do të ju mundësoj ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme qasje më të lehtë në financime, gjithashtu edhe siguri më të madhe për bankën në aspekt të kredidhënies. Marrëveshja u nënshkrua nga drejtori menaxhues i Bankës TEB Sh.A., Ayhan Albeyoglu dhe Edward Nolan, drejtori menaxhues në detyrë i Fondit Kosovar

për Garanci Kreditore, institucion i themeluar me mbështetje të USAID-it në Kosovë. Me anë të kësaj marrëveshjeje, Fondi Kosovar për Garanci kreditore do të mbuloj deri në 50% të rrezikut të kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Kjo i mundëson bankës të zgjerojë kredidhënien për bizneset kosovare. TEB Banka për një botë në lëvizje. (TEB, 21 nëntor 2016).

## HAMZA: MENAXHIMI FINANCIAR ME EFEKT POZITIV NË RITJEN EKONOMIKE




Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka filluar punëtorinë dyditore titulluar “Punëtori për mundësinë e përfshirjes së palëve të interesit në edukimin financiar”, në të cilën marrin pjesë institucione financiare dhe institucione të ndryshme publike në Kosovë. Në këtë punëtori është vlerësuar se edukimi financiar jo vetëm që është i mirë për qytetarët, por ka efekt pozitiv edhe në interesat afatgjata të shtetit dhe rritjen ekonomike të vendit. Guvernatori i BQK-së, Bedri Hamza, theksoi se një ndër qëllimet strategjike të BQK-së është nxitja e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar në Kosovë dhe zhvillimi i mëtejshëm i funksionimit të edukimit financiar me qëllim të krijimit të kulturës së mirëfilltë financiare që u ndihmon të gjitha palëve të interesit për të marrë vendimet e duhura. Petrit Balija, kryetar i Shoqatës së Bankave të Kosovës (ShBK), foli rreth një studimi të bërë së bashku me Bankën Botërore në të cilin ka dalë që qytetarët e Kosovës janë kursimtar të mirë. Ai ka theksuar se arsyet e kursimeve tregojnë se 50% e kursimeve janë më shumë për raste emergjente, që sipas tij, është një gjë shumë pozitive, pasi që kursimi për emergjenca është një ndër kursimet primare. Ndërsa, ka theksuar se arsyeja e moskursimeve të qytetarët lidhet me të ardhurat e ulëta, por edhe mungesa e shprehisë së kursyerit, e cila bënë që qytetarët të mos krijojnë një plan program të kursimeve të rregullta. (Ekonomia Online, 23 nëntor 2016).

# PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“Periodiku Bankar” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.  
[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com).







# Qendra për Trajnime Bankare

## TRAJNIMET PËR VITIN 2016:

Certifikimi Ndërkombëtar EFCB

Bazat e Pajtueshmërisë

Lidershipi dhe formimi i Ekipeve

Menaxhimi i Riskut Operacional

Menaxhimi i Porfolios së Riskut Kreditor

IFRS

Nga Zyrtar i TI në Auditor të TI

Menaxhimi i Riskut të Kredisë dhe Tregut

Trajnimi i Trajnerëve



Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171

[kbtraining@bankassoc-kos.com](mailto:kbtraining@bankassoc-kos.com)



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION